

VENDIM
Nr. 18, datë 14.7.2014

PËR RINOVIM LICENCE SHA UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Rinovim licence për efekt të përfundimit të afatit kategorisë D, të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe drejtuesve teknikë operatorit sh.a. Ujësjellës Kanalizime Durrës, me:

Drejtues ligjor: Spartak Kovaçi;

Drejtues teknik: Adrian Zhamo;

Drejtues teknik :Artor Koçilja.

2. Operatori sh.a UK Durrës autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:

Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

Kategoria C:Për largimin e ujërave të ndotura;

Kategoria D: Për trajtimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është: bashkitë Durrës, Shijak, Vorë, Sukth, Manëz;

Komunat: Prezë, Maminas, Gjepalaj, Katund i ri, Fushë-Kuqe, Bupq Ishëm, Thumanë, Xhafzotaj, Rrashbull.

4. Kjo licencë është e vlefshme për kategoritë A dhe C deri më datë 21.4.2017, siç është përcaktuar në vendimin e KKRR nr. 19, datë 22.4.2013. Afati i vlefshmërisë për kategorinë D, është 1, vit deri më datë 13.7.2015.

KRYETARI

Avni Dervishi